

Këshilla:

- Shmang dhënien e biçikletës në rrugë me shumë trafik. Duhet të veshin masa mbrojtëse si kokore.
- Kujdes me aktivitetet në lartësi (ngjitjen në pemë ose në litar)
- Mbani fëmijën në vëzhgim në vendet me ujë (plazh, pishina, vaska). Dushet nuk përbëjnë problem, por noti duhet të supervizohet gjatë gjithë kohës nga dikush që është i informuar për situatën e fëmijës.
- Prindërit duhet të flasin me mësuesit e fëmijës dhe prindër të tjerë për gjendjen e fëmijës dhe çfarë të bëjnë nëse ndodh një krizë epileptike.
- Inkurajoni fëmijën të flejë mirë dhe të marrë mjekimet në kohë.
- Diskutojeni epilepsinë në mënyrë të hapur dhe të sinqertë me fëmijën.
- Shmangni fjalët ose thëniet që do e bënin fëmijën të ndihej si barrë për të tjerët.
- Inkurajoni fëmijën që të merret me sport, me hobi ose interesat e veta.
- Jepini fëmijës ilaçet në të njëjtin orar ditë për ditë që të krijohet një rutinë.
- Ndhimoheni fëmijën të marri vetë pjesë në marrjen e medikamenteve.
- Sigurohuni që fëmija të flejë mjaftueshëm që të uli riskun e shfaqjes së krizave epileptike.


Përfundim

Ndërkohë që fëmija rritet, ndihmojeni që të bëhet më i pavarur. Shkolla, karriera, martesë si dhe krijimi i familjes janë të mundura për pjesën më të madhe të njerëzve me epilepsi.

Njohja dhe trajtimi sa më shpejt i mundur i krizave epileptike mund të ndihmojë në shmangien e vonësive të zhvillimit dhe të nxënies

Epilepsia quhet e shëruar kur nuk kanë patur kriza për 10 vitet e fundit dhe pa medikamente anti-epileptike 5 vitet e fundit.

Për më shumë informacion drejtoheni tek mjeku i familjes dhe merrni informacion më të plotë dhe të detajuar.



Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve
Adresa: Rruga e Barrikadave, Tiranë
Website: femijetetiranes.al
Facebook: Fëmijët e Tiranës



Bashkia Tiranë
Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve

Epilepsia tek fëmijët



Këshilla për menaxhimin e saj

Këshilla për stafin dhe prindërit

Cfarë është epilepsia?

Shumica e fëmijëve me epilepsi bëjnë një jetë aktive. Ata shkojnë në shkollë, merren me sporte dhe shumë aktivitete të tjera. Sesi ndikon epilepsia në jetën e fëmijës varet nga lloji i epilepsisë, sukcesi në trajtim dhe shumë faktorë të tjerë.

Krizat epileptike janë shenja dhe simptoma kalimtare që vijnë si rrjedhojë e një aktiviteti të sinkronizuar neuronal jo normal dhe i tepruar që karakterizohet nga një aktivitet i papritur dhe i pavullnetshëm i muskujve të skeletit.

Status Epilepticus (SE) është një gjendje që ndodh nga dështimi i mekanizmave përgjegjëse për përfundimin e krizës ose nga fillimi i një mekanizmi që çon në kriza të zgjatura anormale (më shumë se 5 min). Është një gjendje që mund të ketë pasoja afatgjata (sidomos nëse kohëzgjatja është më shumë se 30 min) duke shkaktuar dëmtim neuronal, ndryshim të rrjetit neuronal deri në vdekje të neuroneve në varësi të tipit dhe kohëzgjatjes së krizave^[1].

1-2% e popullatës pediatrike kanë epilepsi. Krizat epileptike ndodhin më shpesh gjatë viteve të para të jetës, në një kohë kur truri pëson ndryshime të mëdha të zhvillimit.

1- Trinka E., Cock H., Hesdorffer D., Rossetti A.O., Scheffer I.E., Shinnar S., Shorvon S., Lowenstein D.H. A definition and classification of status epilepticus—Report of the ILAE Task Force on Classification of Status Epilepticus. *Epilepsia*. 2015;56:1515–1523. doi: 10.1111/epi.13121.—përkthyer dhe përshtatur në Shqip

Si duhet menaxhuar?

Nëse shikoni fëmijën duke bërë krizë epileptike është e rëndësishme që të parandaloni dëmtimin e tij/saj:

1) Vendoseni fëmijën anash shtrirë në pozicionin e sigurisë për të mbajtur fytyrën hapur dhe për të lejuar sekrecionet të rrjedhin lirshëm. Mos u përpiqni të ndaloni lëvizjet e fëmijës. Mos fusni asgjë në gojën e fëmijës dhe mos u përpiqni t'i nxirrni gjuhën. Në momentin që vendoset në pozicionin e sigurisë, gjuha nuk mund të bllokojë rrugët e frymëmarrjes. Disa fëmijë mund të kafshojnë gjuhën gjë që sjell gjakrrjedhje, por zakonisht nuk është diçka serioze.

2) Shikojeni gjithmonë orën! Kriza që zgjasin më shumë se 5 min kërkojnë trajtim të menjëhershëm.

3) Largojeni fëmijën nga rreziqe ambientale (tavinë, divanë shkallë, furrë, në trafik)

4) Qëndroni me fëmijën derisa kriza të përfundojë.

5) Lëreni fëmijën të flejë pas krizës nëse ai/ajo ndihet i/e lodhur. Shpjegoji çfarë ndodhi dhe sigurojeni fëmijën që është i sigurtë pasi të zgjohet.



© AboutKidsHealth.ca

Kur duhet të telefonini

Urgjencën?

- 1) Nëse kriza zgjat më shumë se 5 minuta.
- 2) Nëse fëmija ka vështirësi në frymëmarrje dhe/ose lëkura bëhet blu pas krizës.
- 3) Nëse fëmija është dëmtuar gjatë krizës (psh ka rënë dhe ka përplasur kokën).
- 4) Nëse një krizë tjetër ndodh menjëherë pas krizës së parë ose nëse fëmija nuk përmendet pas krizës.
- 5) Nuk duhet të dërgohet fëmija me status epilepticus në spital me makinë, por duhet marrë ambulanca në telefon.

